



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit SHPK" e datës 24.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 19.10.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi i Autoritetit Kontraktues* i publikuar me datë: 19.10.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit të datës 19.10.2020*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit SHPK" me datë 26.10.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Vendimi i Autoritetit Kontraktues është marrë në baze të Urdhreses së OSHP-se numer 563/20, sipas të ciles detyrohemi të zbatojmë Vendimet e OSHP-se numer 332/20 dhe 82,83,92/20. Ua perkujtojmë se në këto dy Vendime edhe ekspertët dhe Paneli Shqyrtues kanë konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasë të drejte të kërkojë sqarime për çmime jonormalisht të ulta, pasi që këto kërkesa nuk janë në harmoni me nenin 61 të LPP-se dhe me

Rregullat per tenderet jonormalisht te ulet.Ne kemi bere perpjekje te vazhdueshme qe te argumentojme se ka qene kerkese e FDT-se dhe sqarimeve te mevonshme qe tenderuesit ne çmimin e tenderit te tyre duhet te perfshijne te gjitha detyrimet financiare sipas Ligjit te Punes,mirepo keto sqarime nuk kane qene te mjaftueshme per ekspertin dhe Panelin Shqyrtues.Poashtu rekomandim i tyre i vazhdueshem ka qene qe te respektohet parimi themelor i LPP-se dhe qe AK-ja duhet te respektoj vleren e mjeteve te parashikuara dhe te mos paraqet propozime me vlera mbi vleren e parashikuar.Edhe perkunder ketyre rekomandikeve ne jemi perpjekur te argumentojme se vleresimet dhe rivleresimet jane bere ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit,por keto nuk jane pranuar ne vazhdimesi nga OSHP-ja.

Si rezultat i ketyre perpjekjeve te pasukesshme OSHP-ja ka konstatuar se ne nuk kemi zbatuar ne teresi Vendimet paraprake dhe me daten 14.10.2020 ka vendosur qe te aprovoj dhe dergoj Urdheresen numer 563/20.Pasi qe pretendimet tuaja kryesisht nderlidhen me nivelin e detyrimeve financiare ju sqarojme se ne dy Vendimet qe duhet te zbatohen sipas Urdhereses nuk trajtohet kjo çeshtje ose me mire te themi edhe aqe sa trajtohet,trajtohet si diçka qe eshte trajtuar ne kundertshtim me kerkesat e dosjes se tenderit.Prandaj Autoriteti Kontraktues,respektivisht une si Zyrtar pergjegjes i Prokurimit kam vendosur ne baze te te njejtes dhe lidhur me kete arsytimet i keni ne Platformen E Prokurimi,respektivisht ne Vendimin qe i eshte bashkengjitur Njoftimit per Vendimin e AK-se te dates 19.10.2020.

-Pretendimi tjetër se OE-ik i propozuar per dhenje te kontrates nuk ka qene "i pranueshem" ne ditën e publikimit te njoftimit per kontrate,ju sqarojme se kjo nuk qendron,pasi qe i njejti ka sjell deshmi se eshte ne marreveshje me ATK-ne para publikimit te Njoftimit per kontrate(shih bashkengjitur vertetimin e dates 11/04/2019 dhe ua perkujtojme se Njoftimi per kontrate eshte i dates 20.05.2019).Poashtu pretendimet tuaja se i nejjti eshte i pa pergjegjshem me arsytimin se AK-ja disa here e ka shpalle si te tille poashtu jane te pa qendrueshme,sepse Vendimi i fundit eshte marre ne Baze te Urdhereses se OSHP-se,te cilen e kemi obligim ligjor ta respektojme.Nese ju keni verejtje lidhur me kete duhet ti drejtoheni prap OSHP-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet e dhena ne Vendimin per rekomandim te dhenjes se kontrates e gjithnje bazuar ne Urdheresen dhe Vendimet paraprake te OSHP-se vendosi si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:



1000577945

Emri i personit: Name of Person:	International Security Association SH.P.K.
Ime hce: Name of person:	
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number:	
Identifikacioni Lični Broj: Personal Identification Number:	
Numri Fiskal: Fiscal Number:	810836083
Fiskalno Broj: Fiscal Number:	
Komuna: Municipality:	PRISHTINË
Opština: Municipality:	
Data: Date:	11.04.2019
Datum: Date:	
Arsyeja e lëshimit: Reasoning:	Aplikim për Tender
Razlog izdavanja: Reasoning:	

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts

Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih duqova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor. mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.


PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova potvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -

Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:

<https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer>



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

[Regjistrohu \(/Account/Create\)](/Account/Create)[Kyçu \(/Account/LogOn\)](/Account/LogOn)

Kërko Vërtetimin Tatimor

Numri Serik

1000577945

Kërko

Numri Personal

810836083

Emri dhe mbiemri

International Security Association SH.P.K.

Komuna

PRISHTINË

Data

11/04/2019

Arsyeja e lëshimit

Aplikim për Tender

Gjendja tatimore

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura

This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy

Vlefshmëria

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit

The verification is valid for 90 days from the day it is issued

Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

10/26/2020

© 2020 - Administrata Tatimore e Kosovës

Kërko Vërtetimin Tatimor